

Koronavirusi: Informacion mbi vaksinimin në kantonin Zürich

Gjendja më datën 28.04.2021

Vaksinimi është vullnetar dhe falas.

A mund të vaksinohem unë?

Po, nëse ju

- jeni mbi 16 vjeç
- nuk keni temperaturë ose ndonjë simptomë tjetër të COVID-19
- nuk jeni alergjike/alergjik ndaj asnjë përbërësi të vaksinës (PEG)
- nuk jeni në izolim ose në karantinë

Gratë shtatzëna, nënat gjidhënëse, personat alergjikë me reagime të rënda në të kaluarën dhe personat me imunosupresion të rëndë duhet të kërkojnë mendimin e mjekes ose mjekut të tyre, që të mund të vaksinohen. Für eine Impfung im Impfzentrum benötigen sie ein ärztliches Attest.

A mund të regjistrohem tani për vaksinimin?

Dhënia e takimeve për vaksinim bëhet sipas prioritetit të dhënë nga BAG [Enti Federal i Shëndetësisë]. Grupet e vaksinimit të cilave u jepet takim për vaksinimin mund t'i gjeni në **zh.ch/coronaimpfung**.

Personat me sëmundje kronike këshillohen t'i drejtohen mjekes ose mjekut të vet.

Si mund të veprojmë?

Regjistrohuni dhe aplikoni në

zh.ch/coronaimpfung.

Për ndihmë telefononi në: 0848 33 66 11

(shpenzimet brenda Zvicrës janë jo më shumë se 0,08 franga/minuti)

Çfarë të dhënash më duhen?

të dhënat personale, emri dhe numri i Sigurimit shëndetësor.

Ku mund të vaksinohem? Vetëm me prenotimin e mëparshëm të një takimi:



Në qendrat për vaksinim

Affoltern am Albis Holiday Inn Express, Obstgartenstrasse 7

Bülach Stadthalle, Allmendstrasse 8

Dietikon Stadthalle, Fondlistrasse 15

Horgen Seehallen, Seestrasse 87

Meilen Turnhalle Dorfprovisorium (DOP), Schulhausstrasse 23

Uster Sportareal Buchholz, Hallenbadweg 4

Wetzikon Kunsteisbahn, Rapperswilerstrasse 63

Winterthur Rieter-Areal Töss, Klosterstrasse 22

Zürich

Messe Zürich, Wallisellenstrasse 49

Referenz-Impfzentrum der Universität Zürich, Hirschengraben 84

Stadtspital Triemli, Birmensdorferstrasse 497



Në qendrat mjekësore

Personat me sëmundje kronike rekomandohen, që të vaksinohen në një qendër mjekësore.



Në farmaci

Vaksinimi në farmaci do të jetë i mundur prej majit.



Kantoni Zürich
Drejtoria e Shëndetësisë